



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-11
Prishtinë, më 23 janar 2015

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23 DHE ME 26 JANAR 2015**

Mbledhjen e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar.

Kryesuesi i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Nait Hasani, Alma Lama, Visar Ymeri, Valdete Bajrami, Pal Lekaj, Emilija Rexhepi, Duda Balje, Flora Brovina, Muhamet Mustafa, Rexhep Selimi, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha dhe Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Besa Baftija i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me përgjegjësitë për prishjen e mamografit dhe aparaturës tjetër në institucionet publike të shëndetësisë.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Besa Baftija.

Deputeti Daut Haradinaj parashtrroi pyetje për ministrin e të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, në lidhje me përmirësimin e kushteve të punës dhe pajisjes me aparatura të reja për Zjarrfikësit, në kuadër të MPB-së.

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Aida Dërguti i parashtoi pyetje ministrit Arban Abrashi, në lidhje me formimin e Komisionit qeveritar për personat e dhunuar gjatë luftës në Kosovë.
Ministri Arban Abrashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Aida Dërguti.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me masat e ndërmarra ndaj përgjegjësve për prishjen e mamografit mobil.
Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me mjetet prej 5.5 milion eurosh për trajtimin e fëmijëve që vuajnë nga sëmundjet kanceroze.
Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me mosfunksionimin e mamografit mobil.
Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Blerta Deliu-Kodra.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtoi pyetje kryeministrit Isa Mustafa, në lidhje me respektimin e emërimit të Kosovës nga disa ministra të Qeverisë së Kosovës, sipas Kushtetutës së vendit dhe ligjeve në fuqi.
Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtoi pyetje kryeministrit, Isa Mustafa, në lidhje me veprimet e ndërmarra ndaj Ministrit për Kthim dhe Komunitete, Aleksandër Jabllanoviq, për deklaratat e tij fyese ndaj nënave gjakovare.
Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputeti Faton Topalli i parashtoi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me arsyet e prishje në rrugën Ferizaj-Shtime dhe masat që do t'i ndërmarrë Ministria për rregullimin e kësaj rruge.
Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Faton Topalli.

Deputetja Alma Lama i parashtoi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me nxjerrjen e akteve nënligjore të parapara në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjestarëve të UÇK-së, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre.
Ministri Arban Abrashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me ndërhyrjet kirurgjike në Klinikën e Kirurgjisë Kardiovaskulare në QKUK gjatë viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014.
Ministri Imet Rrahmani tha se kësaj pyetje do t'i përgjigjet në seancën e ardhshme.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike,
8. Debat parlamentar lidhur me migrimin ilegal të qytetarëve të Kosovës.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi, pa vërejtje, procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 17 korrik, të vazhduar me 18 shtator dhe 8 dhjetor 2014, më 8 e 9 dhjetor, më 15 dhjetor, më 18 dhjetor, dhe më 29 dhjetor 2014.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në emër të Qeverisë së Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi nxjerrjen e Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit. Ai tha se ky projektligj përcakton veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individuale, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Daut Haradinaj - në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, dhe në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Fadil Demaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Nuredin Ibishi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”; Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Enver Hoxhaj, Faton Topalli, zv/kryeministri Hashim

Thaçi, Arben Gashi, Albin Kurti, Gëzim Kelmendi, Daut Haradinaj, Agim Çeku, Ilir Deda, Alma Lama, Rustem Mustafa, Vjosa Osmani, Rexhep Selimi, Labinotë Demi-Murtezi, Ismajl Kurteshi, Xhevahire Izmaqi, Mytaher Haskuka, Ganimete Musliu dhe ministri Skender Hyseni, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plotë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 74,
Kundër ----- 12,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Kuvendi i ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht.

Ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, në emër të Qeverisë së Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi nxjerrjen e Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht. Ai tha se ky projektligj ka për qëllim rregullimin e përdorimit të mbikëqyrjes elektronike në procesin e drejtësisë penale për të ngritur sigurinë publike dhe për të garantuar ekzekutimin efektiv të vendimeve të gjykatës dhe të Panelit për Lirim me Kusht, duke i respektuar plotësisht të drejtat e personave të përfshirë.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Hajredin Kuçi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu- në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Selville Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Valdete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, Qerim Bajrami, në emër të Grupit

Parlamentar “6+”, si dhe ministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 70,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ministri Hajredin Kuçi, në emër të Qeverisë së Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi nxjerrjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Ai tha se ky projektligj ka për qëllim harmonizimin e dispozitave ligjore dhe shmangien e konfliktit ligjor pas datës 1 janar 2013.

Hyrja në fuqi e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, më 1 janar 2013, ka determinuar edhe ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Hajredin Kuçi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu- në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Agim Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Agim Ademaj - në emër të Grupit Parlamentar të

LDK-së; Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Valdete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Qerim Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe, ministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 83,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për përgjimin e komunikimeve elektronike.

Ministri për Integritet Evropian, Bekim Çollaku, në emër të Qeverisë së Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi nxjerrjen e Projektligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike. Ai tha se ky projektligj përcakton rregullat dhe procedurat për operatorët e rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve në lidhje me përpunimin e të dhënave të caktuara nga operatorët e rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve, në mënyrë që të sigurohet se të dhënat janë në dispozicion me qëllim të hetimit, zbulimit dhe ndjekjes së krimeve të rënda përmes përgjimit të ligjshëm të komunikimit elektronik, të kërkuar nga institucionet e autorizuara me qëllim të zbatimit të ligjit dhe të sigurisë kombëtare.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Diskutimi i ministrit Bekim Çollaku, është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike.

Teuta Sahatqija, në emër të Komisionit për Integritet Evropian, tha se ky komision e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar që të mos e miratojë. Fjala e znj. Teuta Sahatqija është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Rustem Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Ilir Deda, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar LS,

Valdete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Kujtim Paçaku, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe ministri, Bekim Çollaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për përgjimin e komunikimeve elektronike.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 3,
Kundër ----- 74,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

VENDIM

1. Kuvendi nuk miratoi në parim Projektligjin për përgjimin e komunikimeve elektronike.
2. Projektligji për përgjimin e komunikimeve elektronike i kthehet Qeverisë për rihartim.

8. Debat parlamentar lidhur me migrimin ilegal të qytetarëve të Kosovës

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të deputetëve nënshkrues, propozoi që kjo pikë të shtyhet për datën 26 janar 2015.

Pastaj, kryesuesi kërkoi deklarinë e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetes, Donika Kadaj-Bujupi.

Për propozimin e deputetes, Donika Kadaj-Bujupi, u deklaruan deputetët: Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymer, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Sasha Millosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar LS, Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, Qerim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e lartpërmendur të deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash, miratoi propozimin e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, për shtyrjen e debatit parlamentar lidhur me migrimin ilegal të qytetarëve të Kosovës, për datën 26 janar 2015, në orën 13:00.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 16:40 minuta.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ndërsa i ndihmoi Xhavit Haliti, nënkryetar.

Kryetari i procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

8. Debat parlamentar lidhur me migrimin ilegal të qytetarëve të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët me kërkesën e Grupit Parlamentar i AAK-së dhe deputetëve tjerë nënshkrues, për të debatuar në lidhje me pengimin e migrimin ilegal të qytetarëve të Kosovës jashtë vendit.

Ai e ftoi përfaqësuesen e Grupit Parlamentar të AAK-së ta marrë fjalën.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, në emër të propozueses të debati tha se sipas statistikave vetëm në vitin 2014, janë 30 mijë qytetarë të regjistruar si migrues ilegalë ose azilkërkues në vendet e Evropës, por edhe më e madhe është shifra jozyrtare e të larguarve realë, sidomos kur kësaj i shtohen edhe të larguarit joazilkërkues nga Kosova.

Largimi masiv i qytetarëve të Kosovës tregon më së miri gjendjen aktuale, ekonomike e sociale të vendit. Ky largim nëpërmjet rrugëve ilegale e rrezikon jetën dhe shëndetin e qytetarëve dhe është tejet i rëndë në aspektin logjistik, atë të sigurisë dhe është tepër i kushtueshëm në aspektin financiar.

Kjo gjendje e rëndë vetëm vështirësohet edhe më shumë kur i kemi të publikuara masat policore nga Qeveria e re e Kosovës. Migrimi nuk është çështje policore, e as nuk mund të zgjidhet me masa policore. Është detyrë dhe obligim i të gjitha institucioneve që ta trajtojnë këtë çështje me seriozitet, me vendosmëri dhe me shpejtësi.

Është detyrë dhe obligim i Kuvendit, që të diskutojë dhe ta obligojë Qeverinë për masat që duhen ndërmarrë për ta sanuar këtë gjendje.

Sot, fatkeqësisht, në dekadën e dytë pas luftës, po na përsëritet thuajse e njëjta situatë, me shifra alarmante të ikjes. Por, me një dallim, atëherë qytetarët e Kosovës iknin për t'u kthyer kur Kosova të çlirohet, ndërsa sot po ikin për shkak të mungesës së perspektivës, humbjes së besimit në institucione dhe humbjes së shpresës që në Kosovë mund të bëhet mirë.

Ajo theksoi se mirë do të thotë të ketë një vend pune për ata që përfundojnë studimet, t'u ofrohet qytetarëve shërbim shëndetësor adekuat, të kenë arsim cilësor për fëmijët e tyre, ta realizojnë një të drejtë edhe nëse nuk e njohin gjykatësin, ta mbjellin arën e tyre duke pasur qasje në subvencione, pavarësisht nëse i takojnë partisë në pushtet apo jo, të regjistrohen në fakultet bazuar në kriteret e dijes, e jo në baza nepotiste.

Çfarë ka ndodhur në Kosovë? Pritjet, që me marrjen e përgjegjësisë nga vendorët dhe pas krijimit të shtetit do të punohet në zhvillim dhe ndërtim të vendit u venitën nga viti në vit, sidomos pas shpalljes së pavarësisë.

Shpresa për mundësi dhe për zhvillim ekonomik në shtetin e shumëpritur u zëvendësua me lajme për rritje të korrupsionit, të krimit në vend, ngushtimit të hapësirës për të ushtruar biznes, mungesës së investimeve, mungesës së sigurisë dhe mbi të gjitha, arrogancës së Qeverisë. Përgjigjja për këtë situatë nga qytetarët e pashpresë, rezultoi me migrimin, vala e të cilëve u shtua sidomos në momentin kur nëpërmjet këtij binomi politik, koalicionit PDK-LDK, u konfirmua vazhdimësia e kësaj gjendjeje degraduese në vend.

Fatkeqësisht, nga viti në vit, shifrat për migrimin e qytetarëve të Kosovës çdo ditë janë më shqetësuese. Sipas ministrit të Landit në Gjermani, numri i të ikurve është rritur 365%, në krahasim me vitin e kaluar.

Ajo pyeti se çka ka bërë Qeverisja e djeshme dhe kjo e sotmja për këtë dukuri.

Konform obligimit tonë, që është edhe ligjor, por edhe moral, e kemi propozuar Propozim-rezolutën, mbi bazën e së cilës do të diskutojmë sot, duhet t'i harmonizojmë qëndrimet edhe me grupet tjera parlamentare dhe të votohet, pra ta obligojmë Qeverinë që të ndër marrë hapa konkretë për të krijuar perspektivë, prosperitet dhe besim.

Në fund, ajo e paraqiti tekstin e propozim-rezolutës, që në fund të këtij debati do të harmonizohet edhe me grupet e tjera parlamentare.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Aida Dërguti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ramush Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Valdete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”; Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Zenun Pajaziti, Vjosa Osmani, Ismajl Kurteshi, Blerim Shala, Zafir Berisha, Shaip Muja, Besim Beqaj, Anton Quni, Puhie Demaku, Bali Muharremaj, Shukrije Bytyqi, Qerim Bajrami, Margarita Kadriu-Ukelli, Emilija Rexhepi, Armend Zemaj, Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Fikrim Damka, Bekim Haxhiu, Njomza Emini, Salih Salihu, Teuta Haxhiu, Haxhi Shala, Kujtim Paçaku, Ramiz Kelmendi, Salih Morina, Fisnik Ismaili, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi, Xhevahire Izmaqu, Shpejtim Bulliqi, Besa Baftija, Melihate Tërmmkolli, Mexhide Mjaku-Topalli, Nuredin Ibishi, Mytaher Haskuka, Hajdar Beqa, Veton Berisha, Rustem Berisha, Etem Arifi, Hatim Baxhaku dhe nënkryetari Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Donika Kadaj-Bujupi, në cilësinë e propozuesit të çështjes, e paraqiti Propozim-rezolutën, të harmonizuar edhe me grupet e tjera parlamentare.

Kryesuesi tha se Propozim-rezoluta, sipas nenit 52.2 të Rregullores së Kuvendit, nuk i plotëson kushtet për ta hedhur në votim. Gjithashtu, para se të hidhet në votim kjo rezolutë, duhet të konsultohet edhe Komisioni për Buxhet e Financa dhe komisionet e tjera parlamentare.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 19:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*